

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni, kryetar i kolegjit, Albert Zogaj dhe Nora Bllaca-Dula, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses M.H. nga Prishtina, Lagja “...” Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B-Y., avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e dy pagave për përcjellje në pension dhe dy pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit juridik të të paditurës, e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2088/2012 të datës 31.03.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur më dt.06.09.2017 mori këtë

## A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e përfaqësuesit juridik të të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Arsimit, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2088/2012 i datës 31.03.2014, dhe gjykohet si vijon:

REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M.H. nga Prishtina, dhe detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Arsimit që paditëses brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, t’ia paguaj dy paga mujore për shpërblim jubilar dhe dy paga mujore për përcjellje në pension në shumën e përgjithshme të parave prej 1401 €, bashkë me kamatën në lartësi prej 3.5 %, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Detyrohet e paditura që paditëses në afatin kohor prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 165 €.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovet kërkesëpadia e paditëses M.H. nga Prishtina dhe detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Arsimit që paditëses brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, t’ia paguaj dy paga mujore për shpërblim jubilar dhe dy paga mujore për përcjellje në pension në shumën e përgjithshme të parave prej 1401 €, bashkë me kamatën në lartësi prej 3.5 %, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Detyrohet e paditura që paditëses në afatin kohor prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 165 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesa ka paraqitur përfaqësuesi juridik i të paditurës, për shkaqet ankimore të parashikuara me dispozitën e nenit 181 par.1 pika a), b) dhe c) të LPK, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset, dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja, me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe të përgjigjes në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: paditësja në padinë e saj të paraqitur më datën 26.07.2012, si dhe në shqyrtimet gjyqësore, përmes të autorizuarës së saj ka theksuar se për 32 vite ka qenë në marrëdhënie pune në vendin e punës arsimtare, e ciklit të ulët në Shkollën Filllore “...” në Prishtinë, derisa me vendimin e datës 13.06.2012, është pensionuar. Sipas paditëses e paditura nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 42, 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, në atë mënyrë që paditëses nuk ia ka paguar tri pagat mujore, për përcjellje në pension, dy paga për shpërblim jubilar si dhe regresin për pushim vjetor, në shumën e parave në lartësi prej 1921.50 €. Kërkesën e saj përfaqësuesja e autorizuar e paditëses, e ka precizuar në shqyrtimin gjyqësor duke hequr dorë nga kërkesa për regres, ndërsa për kërkesat tjera ka mbetur si në padi.

Ndërkaq, nga përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, është kundërshtuar kërkesëpadia e paditëses me arsyetim se me dispozitat e Rregullores për Shërbyesit Civil nr. 2001/36 dhe Ligjit nr. 03/L-212 nuk është përcaktuar mënyra e pagesës së pagave, siç është kërkuar nga paditësja, ndërsa dispozitat e Kontratës Kolektive në rastin konkret janë të pa zbatueshme. Ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe i ka vlerësuar ato dhe ka vërtetuar se, nuk ka qenë kontestues fakti se paditësja ka qenë arsimtare e ciklit të ulët në Shkollën Filllore “...” në Prishtinë, nga i cili vend pune është pensionuar për shkak të arritjes së moshës për pension. Nuk ka qenë kontestues edhe fakti se paditësja për punën e kryer te e paditura, lartësinë e pagës e ka pasur 350.30 € në muaj. Kontestuese ka mbetur zbatimi i Kontratës së Përgjithshme Kolektive, në rastin konkret apo jo.

Me vendimin e të paditurës 03 nr.118-23644 të datës 05.07.2012 rezulton se Drejtoria e Arsimit në Prishtinë, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditëses. Po me këtë vendim në paragrafin III të tij, ishte përcaktuar se M.H., (tani paditësja) konform të dispozitave të Kontratës Kolektive do të realizoj paushallin për përcjellje në pension.

Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin e paditëses e paditura ka marr detyrime për kompensimin e dy pagave për përcjellje në pension dhe dy pagave për shpërblim jubilar të cilin e paditura e ka pohuar në vendimin për pensionimin e paditëses në pikën III.

Gjykata e shkallës së parë këtë gjendje faktike të çështjes e ka bazuar në dispozitat e neneve 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive si dhe nenin 452 par. 1 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK, mirëpo gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses për pa pasur ndonjë mbështetje të bazuar ligjore.

Për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi është dashur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar, e këtë në bazë të nenit 195 par. 1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK.

Këtë qëndrim juridik gjykata e shkallës së dytë, e mori për arsye se paditësit vërtetë i është njohur e drejta në pension bazë dhe kontributiv që nga data 19.06.2012.

Në këtë çështje konkrete juridike bindshëm dhe sigurt është vërtetuar se Kontrata kolektive e cila është thënë se zbatohet që nga 1 janari 2005, mirëpo e njëjta si e tillë nuk është zbatuar në dispozitat e cekura të saj, këtë konstatim e ka bërë edhe Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimet e saj të cilat i referohen çështjes së pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin me pensionimit. Nga kjo rrjedhë se Kontrata kolektive as nuk është vazhduar më tutje dhe mbi këtë bazë aktgjykimi i atakuar është dashur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses është refuzuar në bazë të dispozitave të lartë cekura. Kjo për faktin se pensionimi i paditëses ka ndodhur në vitin 2012.

Gjykata e Apelit e konsideron si të pa bazuar kërkesë padinë e paditëses, meqë paditësja e ka fituar të drejtën e pensionit bazë dhe kontributiv me datën 19.06.2012, në kohën kur ka qenë në fuqi Rregullorja mbi Pensionet në Kosovë, me të cilën në asnjë nen të saj nuk parashihet pagesa e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension, ndërsa në nenin 35 të të njëjtës Rregullore parashikohet se kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me te.

Prandaj, Gjykata e Apelit vlerësoi se aktgjykimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së përmendur, kështu që paditësja pa të drejtë kërkon pagesën e tillë bazuar në Kontratën e Përgjithshme Kolektive, pasi që kjo kontratë deri më tani për shërbyesit civil nuk është zbatuar.

Të drejtat dhe detyrat e personelit të punësuar në arsim, janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr. 03/L-212, i cili ka hy në fuqi më datën 01.11.2010, e i cili Ligj nuk ka paraparë asnjë beneficion apo privilegj për personat të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore me mbushjen e moshës së pensionimit, ndërsa ende është në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2001/35 e datës 22.12.2001, dhe Rregullorja 2005/20 datë 29.04.2005, për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë e cila me nenin 4 paragrafi 1 parashikon që administrata udhëheqë dhe administron pagesën e pensioneve bazë për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët arrin moshën e pensionimit, dhe paragrafi 2 i nenit në fjalë parashih shumën e pensionit bazë e cila përcaktohet sipas metodologjisë të cilën e miraton Kuvendi i Kosovës.

Pasi që paditësja ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë në kohën kur është në fuqi Ligji i Punës nr. 03/2 – 212 dhe Rregullorja e cekur më lartë për pensionet në Kosovë me të cilat në asnjë nen të saj nuk parashihet pagesa e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension, ndërsa në nenin 35 të të njëjtës Rregullore parashikohet se kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të Ligjit në fuqi që është në kundërshtim me te, atëherë nuk ka kurrfarë logjike juridike që kërkesë padia e paditëses të aprovohet.

Prandaj pretendimet ankimore të paditurës në këtë drejtim, gjykata e shkallës së dytë i konsideron të bazuara dhe nga këto arsye si edhe ato të cekura më lartë, vendosi që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoi.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi e këtë në bazë të nenit 195.1 nën pikën e) e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d) të LPK.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË  
AC.nr.3789/2014 të datës 06.09.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI  
Gëzim Llulluni